



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUČITRN	
Nr. / Br.	44849123
Nr. i fq. / Br. st.	13.09.2023
Data: / Datum:	VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRISË

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2024, të mbajtur me 11.09.2023, i organizuar nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës dhe Drejtoren për Buxhet dhe Financa, të mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës me fillim nga ora 11:00.

Të pranishëm nga Komuna ishin: Melihate Basholli Latifi-Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Isuf Jashari-Drejtor për Buxhet, Financa dhe Thesar, Hava Mlinaku-Drejtoreshë e Administratës, Remzi Ahmeti-Drejtor për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Medina Bunjak-Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport, Dardan Abazi-Drejtor për Arsim, Maliq Ferizi-Drejtor për Mbrojtje dhe Shpëtim, Fortuna Krasniqi-Drejtoreshë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Ergin Sunguri-Drejtor për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Melihate Basholli Latifi**, kryesuese e Kuvendit të Komunës, e cila i falënderoi qytetarët për pjesëmarrjen në dëgjimin publik për buxhetin e vitit 2024.

Isuf Jashari, drejtor për Buxhet, Financa dhe Thesar, para qytetarëve të pranishëm prezantoi draft-buxhetin e vitit 2024. Ai tha se prioritetet kryesore janë kanalizimet dhe ujësjellësi. Të gjitha kërkesat paraqiten në Kuvendin e Komunës dhe anëtarët e Kuvendit votojnë.

Milazim Hyseni, drejtor i Shkollës "Ali Kelmendi", kërkoi të zgjidhet çështja e pronësisë e cila ka mbetur e pazgjidhur. Për të njëjtën shkollë tha se nuk ka asnë investim, kërkoi të renovohet objekti përcjellës. Theksoi se kolektivi ka bërë të pamundurën për këtë shkollë me buxhet privat. Kemi kërkesë emergjente për ndërtimin e një salle sportive, salla të jetë si në qendër ose sikurse salla në fshatin Samadrexhë, salla të shfrytëzohet për nxënës dhe për të rinjtë e asaj zone.

Remzi Ahemi, drejtor për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, sqaroi se prona e shkollës "Ali Kelmendi" është e kooperativës bujqësore. Komuna ka filluar proceduarat për kthimin në pronë komunale.

Dardan Abazi, drejtor i Arsimit, theksoi se kjo shkollë është në listën e shkollave për rregullimin e fasadës së jashtëm.

Arben Beka, përfaqësues i lagjes Kërçova, tha se 400 m kanalizim dhe disa shërbime të tjera i ka financuar vetë. Pati kërkesë që Ruga Kërçova të asfaltohet dhe të kontrollohet kanalizimi.

Melihate Basholli Latifi, kryesuese e Kuvendit të Komunës, sqaroi se rruga duhet të jetë në pronë publike.

Vildane Mulaku, kryetare e Shoqatës së Martirëve të Lirisë, kërkoi të bëhet renovimi në tërësi i objektit të Shoqatave të dala nga lufta. Të bëhet rregullimi i pjesës së mbetur të varrezave, të bëhen varret e njëjtë për të gjithë martirët në varrezat "2 Maji".

Sevdije Sadiku, banore e Vushtrrisë, tha se duhet që Vushtrria të ketë një stacion të autobusëve. Duhet të bëhet pastrimi i qytetit, riciklimi i mbeturinave. Projekte për punësim Start-UP. Projektet për sera. Te ndriçohen me drita varrezat e dëshmorëve te UÇK-së.

Ergin Sunguri, drejtor për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural, për çështjen e serave projekti është 2 yjeçar në bashkëpunim me Islamic Relief-in.

Fikrije Ferizi, drejtoreshë e Organizatës së Gruas “ATO”, kërkesë për renovimin e objektit ku ndodhen shoqatat. Subvencionim të shoqatave të grave për trajnime dhe ligjërimë për vetëdijesimin për sëmundje të ndryshme. Të ndahen grante 50/50.

Fehmi Shala, kryetar i Këshillit Lokal Stanoc i Epërm, tha se komuna ka bërë investime, por është një kërkesë që duhet të zgjidhet problemi i ujit të pijes në disa shtëpi. Ka pasur investime në shkolla, shkolla tek Cakajt, shkolla Migjeni dhe tek shkolla ne Lumadh. Në Gracë është gjendja shumë e keqe për ujë të pijes dhe kanalizim.

Muhamed Rashani, përfaqësues i fshatit Samadrexhë, prioriteti numër 1 i këtij fshati është furnizimi me ujë te pijes. Ndërsa kemi marr iniciativë fshati me vetë financim për rregullimin e varrezave (rrethojën), nga Komuna kërkojmë vetëm ta hapë rrugën tek varrezat që është 450m në mënyrë që të mund të fillojmë me rrethojën e varrezave dhe në raste të ceremonive të varrimit po bllokohet rruga kryesore. Lumi në Samadrexhe është pastruar por ka edhe shumë përroska që duhet të pastrohen.

Maliq Ferizi, drejtor për Mbrojtje dhe Shpëtim, tha se rruga do të përfundohet me rikonstruim.

Lulzim Surdulli, nga fshati Samadrexhë, kërkoi që të mbahen mbledhjet e këshillit të prindërve në shkollën e fshatit Samadrexhë, pasi që nuk po lejohen t'i mbajnë. Të renovohet salla sportive në fshatin Samadrexhë. Të bëhet një qendër e zjarrfikësve në Samadrexhë. Kanalizimi duhet të bëhet në këtë fshat. Kërkesë tjetër është që të bëhet shtatorja e “Heroit Lumni Surdulli” tek rrethi te INTEREX.

Dardan Abazi, drejtor i Arsimit, tha se do ta trajtojnë çështjen që Këshilli i prindërve t'i mbajë mbledhjet në shkollën e fshatit.

Sabile Gjaka, kryetare e grave të fshatit Oshlan, paraqiti dy kërkesa, e para dhënen e kultivatorëve për gratë e fshatit Oshlan, dy të bëhet një lokacion që të mbahen takimet e grave të Shoqatës.

Shukrije Krasniqi, përfaqësuese e shoqatës Doën Syndrome, falënderoi komunën për ndihmesat e deritanishme, ndërsa kërkoi një fond të veçantë për një pushim 5 ditor për fëmijët me Doën syndrome.

Xhemajl Bojku, përfaqësues i fshatit Druar, kërkoi ndricimin e rrugës Druar-Reznik. Të ndërmerret diçka për shkollën e vjetër të fshatit Druar e cila ka mbetur gjysmë e rrënuar. Të bëhet renovimi i fushës së sportit që gjendet në oborrin e shkollës. Ne fshatin Mihaliq tek lagjja Syla të hapet rruga e kësaj lagje në mënyrë që nxënësit të kenë më të lehtë rrugën për në shkollë. Të ndërtohen depo për shkolla.

Hysni Bekteshi, nga fshati Stanoc i Poshtëm, i dorëzoi kërkesat për fshatin Stanoc i Poshtëm dhe Lumadh.

Rrahim Parduzi, kërkoi zgjidhjen e çështjes së ujësjellësit, kanalizimit, kërkoi asfaltim të rrugëve dhe ndriçimin e rrugëve si dhe rregullimin e shtyllave elektrike.

Përveç në dëgjimin publik, komente dhe kërkesa janë pranuar edhe përmes emailit, e të cilat janë:

Faton Jashari, banor i fshatit Stanoc i Poshtëm, projektet për fshatin Stanoc i Poshtëm:

1. Ndërtimi i trotuarit së bashku me stazhë për bicikleta dhe ndriçimin e mbetur, në rr.Sadri Maksuti (rr.e.Prekazve) deri te Xhamia e fshatit, si dhe zgjerimi i hyrjes dhe daljes së kësaj rruge nga magjistralja.
2. Eliminimi i pengesave (policët e shtrirë) në rrugën Fehmi Ademi dhe zëvendësimi i disave prej tyre me Polic të Shtrirë të vendosur në mënyrë profesionale.
3. Projekt tejet i rëndësishëm për fshatin tonë bashkë me fshatrat përrethështë ndërtimi dhe funksionalizimi i një Kopshti (Çerdhe) publike në fshatin Stanoc i Poshtëm, ky projekt mund të jetë projekt afatgjatë varësisht nga Buxheti, andaj është e rëndësishme të filloj qysh ne vitin e parë qeverisës.
4. Ne fshat kemi nevojë edhe për Kanalizim, Asfaltim dhe Ndriçim të rrugëve të ndryshme, andaj ta keni parasysh që për vitin 2022 ti parashikoni mjetet për këto projekte jetike për qytetarët tonë.
5. Ndërtimi i një rrugice dhe Ure mbi lumin Llap, e kalueshme edhe për Automjete që lidh lagjen e Durakve me pjesën tjeter të fshatit aty ku ka qenë ura e këmbësorëve, si dhe eliminimi i një deponie në po atë vend.
6. Largimi i deponisë së mbeturinave të ngurta, që është instaluar në mes të fshatit afér shkollës, dhe ndërtimi i një fushe sporti të përmasave mesatare, së bashku me një park për rekreacion në po të njëjtin vend.
7. Rregullimi kryçes së rr.Fehmi Ademi në drejtim të Vushtrrisë, duke ndërtuar një korsi të veçantë njëkahore, ose në bashkëpunim me ministrinë e infrastrukturës ndërtimi i një rreth rrotullimi në magjistralen Prishtinë-Mitrovicë, gjegjësisht në vendin ku lidhet rr.Fehmi Ademi me Magjistralen.
8. Ndërtimi i një fushe të vogël sporti në lagjen e Prekazve
9. Rr.“Fehmi Ademi” Renovimi i Trotuarit dhe vendosja e rrethojës anash trotuarit, rregullimi i kanalizimit atmosferik.
10. Nevojë urgjente është identifikimi dhe realizimi i të gjitha projekteve që kanë qenë të parapara me u përfundu me buxhetin e vitit 2021 dhe nuk janë realizuar akoma.

Shtjellim në detaje i nevojave për kanalizim, asfaltim dhe ndriçim të rrugëve.

Asfaltimi i rrugëve:

- Lagija e Morinve afersisht 280m (kjo rrugë e parapame ne buxhetin e vitit 2021 e pa perfundume)

- Lutfi Menxhiqi afërsisht 150m
- Bedri Morina afërsisht 40m
- Besnik Duraku afërsisht 50m
- Fidan Duraku afërsisht 120m
- Mursel Rama afërsisht 25m
- Brahim Rama afërsisht 15m
- Musaj Rama afërsisht 25m
- Blerim Rama afërsisht 35m
- Mergim Rama afërsisht 25m
- Ali Muhagjeri afërsisht 200m te sera
- Rexhep Hyseni afërsisht 30m
- Iset Rama afërsisht 70m
- Abaz Rama afërsisht 60m
- Hysen Rama afërsisht 25m
- Sami Rama afërsisht 25m
- Adem Rama afërsisht 80m
- Rr.Flaka e Janarit afër 570m deri te Serat (e planifikuar për 2021 e pa përfunduar)
- Riad Klinaku afërsisht 25m
- Sylejman Klinaku afërsisht 25m
- Salih Klinaku afërsisht 25m
- Faik Klinaku afërsisht 25m
- Sahit Muhaxheri 30m
- Rifat Muhaxheri 20m
- Hamit Skroma afërsisht 50m
- Zen Cej afersisht 50m
- Shemsi Segashi afërsisht 130m
- Sadri Muhaxheri afërsisht 120m
- Daut Segashi deri te ferma 50m
- Nezir Jashari afërsisht 50m
- Arsim Konushevci afërsisht 120m
- Hilmi Asllani afërsisht 120m
- Milaim Muhaxheri afërsisht 35m
- Rasim Islami afërsisht 150m

Kanalizim:

Lagija e Morinve afërsisht 280m
 Te Plakollt afërsisht 450m
 Te Aziz Tahiri afërsisht 75m
 rruga
 Sadri Muhaxheri afërsisht 120m
 Abaz Rama afërsisht 70m

Përbledhje: Gjatë identifikimit të nevojave për rrugë me asfalt në fshatin tonë kemi ardhë në përfundim që na duhen në total afërsisht prej 2.5km deri në 3.0km gjatësi, këtu bëjnë pjesë edhe rrugë të cilat janë të kontraktuara por që nuk kanë përfundu akoma (siç i kam cek me lart), po ashtu kemi identifiku nevojën për kanalizim në gjatësi prej 1.0km dhe nevoja për ndriçim të rrugëve që janë shumë të vogla.

Kërkoj nga Komuna e Vushtrrisë që të planifikoj mjete në planifikimin e buxhetit për vitin 2024 – 25 për ndërtimin e një çerdheje publike në Stanoc të Poshtëm me kapacitet të nevojshëm ku i përfshin fshatrat e lokaliteti: Stanoc i Poshtëm, Stanoc i Epërm, Lum i madh dhe Gracë. Kërkesën e bazoj në nevojën për një institucion të edukimit të hershëm për fëmijët tanë, gjë

Ndriçim i Rrugëve:

Lagija e Morinve 5 drita
 Te Hajzeri 4 Drita
 Rr. Gjon Kenedi te Durakt komplet

që është qenësore, tjetra duke pas një çerdhe në këtë lokalitet gratë e këtij lokaliteti kanë me pas mundësi me punu duke kontribuar kështu drejtpërdrejt në ngritjen e mirëqenies familjare, tjetra pasi ky lokalitet nuk është duke u zvogëlu por dita ditës banorët në këtë lokalitet po rriten, edhe kjo e arsyeton investimin. Unë jam në dijeni se këtë çerdhe e keni planifikim me ndërtu në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, mirëpo në rast të dështimit të Ministrisë, Komuna duhet të jetë e gatshme këtë investim ta bëjë me mjete vetanake (andaj rekomandoj planifikimin) pasi ka qenë edhe premtimi kryesor elektoral dhe duhet përmbrushur brenda mandatit.

Qamil Sahiti, nga Vushtrria, ju përgëzoj për punën e mirë që po bëni për komunën tonë. Sa i përket Buxhetit për vitin 2024, ju lus që të insistoni që në planifikim të parashihet një shumë e veçantë për shënimin e 100 vjetorit të rënies së Azem Bejtë Galices. Besoj se nuk kam nevojë të flas për heroin e kombit e as për rëndësinë dhe veçantinë që duhet organizuar ne Korrik 2024. Përveç organizimeve të ndryshme, do kishte qenë mirë të parashihej edhe një buxhet shtesë për vendosjen e shtatores së Azemit e Shotes në Vushtrri.

Tahir Musliu, banor i fshatit Maxhunaj, rruga "Ura e gurit" nr.8, në këtë lagje, rruga "Ura e gurit" jana 11 shtëpi, të ndërtuara pas luftës. Kanalizimin, ujësjellësin dhe rrugën në zhavor e kemi krye me vet financim. Asfaltimi i rrugës, afro 500m edhe pse e kemi fut në projekt për vite me radhë, ka dështu e nuk u marr parasysh. Banorët e lagjes "Ura e gurit", Maxhunaj kërkon nga kryetari i Komunës së Vushtrrisë të ketë parasysh këtë kërkesë, që edhe kjo lagje të e ndien ndihmën e Komunës, jo veç të kemi pagesë të tatimeve. Përfaqësuesit e lagjes kanë qenë prezent në mbledhjen e organizuar për buxhet në fshatin Maxhunaj, ne kemi propozuar këtë projekt jetik për lagjen. E lusim kryetarin e Komunës, ta ketë parasysh këtë kërkesë pasi votat i ka marrë komplet prej lagjes.

Muhamed Rashani, kryetar i Këshillit Lokal Samadrexhë, së bashku me familjarët e heroit, Lumni Surdulli, kërkojmë nga kryetari i komunës që ta merr parasysh këtë kërkesë për vendosjen e shtatores së heroit, Lumni Surdulli, në rrëthrotullimin afér interexit. Jeta dhe vepra e lavdishme e heroit të kombit, Lumni Surdulli, është heroike dhe ne si bashkëvendës të tij e kemi obligim që ta kujtojmë përherë, prandaj vendosja e shtatores së tij në rrëthrotullim do ta bëj edhe më të bukur qytetin e Vushtrrisë.

Sabri Haradinaj, nga fshati Stanoc i Epërm, kemi nevojë për rregullimin e urës se është dëmtu nga vërshimet dhe një muri mbrojtës se pas çdo vërshimi po rrezikohet familja dhe po kemi dëme të mëdha në shtëpitë tona. Ju lutem te merrni parasysh këtë kërkesë timen sa më shpejt.

Shemsije Maloku, përfaqësuese e fëmijëve me sindromën doën të Komunës së Vushtrrisë. A mund të sigurohet një fond nga ana e juaj për fëmijët me sindromën doën me bë një pushim 5 ditor në Shqipëri për këta fëmijë së bashku me nënët 1 herë në vit.

Faton Hyseni, banor i fshatit Stanoc i Epërm, rregullimin e trotuarit në rrugën Sadik Mala, Gracë, në gjatësi prej 300 m, duke filluar nga magjistralja. Kjo për arsy se ka frekuentim shumë të madh të qytetarëve e sidomos të nxënësve dhe të rinjve dhe po rrezikohet siguria e tyre nga veturat dhe automjetet që kalojnë vazhdëmisht. 2. Ndërtimin e një Aneksi në SHFMU "Nazmi Zhegrovë", Stanoc i ulet, kjo për faktin se është rritur jashtëzakonisht shumë numri i nxënësve dhe objekti aktual nuk ofron hapësirë për të akomoduar të gjithë nxënësit dhe po paraqet vështirësi në realizim të procesit mësimorë. 3. Ish objekti i ShFMU "Migjeni", të hyjë në projekt buxhet, për tu shndërruar në çerdhe. Kjo për faktin se ka shumë kërkesa për ndërtimin e një çerdhe në Stanoc të Epërm, poashtu kjo kërkesë bazohet edhe në pëlqimin

paraprak të Kuvendit Komunal të Vushtrisë. Shpresoj se kërkesat e lartpërmendura të realizohen sa më shpejtë dhe të ndikojnë direkt në sigurinë, dhe në përmirësimin e jetës së qytetarëve në këto tre fshatra.

Rrahim Ajeti, kryetar i Këshillit Lokal Stanoc i Poshtëm-Lumadh, i paraqiti dy kërkesa me shkrim, një për Stanoc të Poshtëm dhe një për Lumadh.

Kërkesat për fshatin Stanoc i Poshtëm: Asfaltimi i rrugëve lokale 3000 metra gjatësi, rrugë të rendit të 4-të 6000 metra gjatësi, trotuar 2000 metra gjatësi dhe shtegu i bicikletave, ndërtimi i urës në lagjen e Duraku, kanalizim 2500 metra gjatësi, ndriçim publik 1200 metra gjatësi (apo 50 drita), intervenim të shpejtë në stafin e shkollës ku nuk mbahen orët mësimore me rregull nga arsimtarët dhe ndërrimi i menjëhershëm i menaxhmentit të shkollës dhe shtimi i një aneksi, pasi që çdo vit po rritet numri i nxënësve të shkollës në fshatin tonë, rregullimi i dy fushave sportive, njëra në lagjen e Prekazi dhe tjetra tek shkolla, rregullimi i çerdhes për fëmijët, rregullimi i një parku tek "Ledina e ulët".

Kërkesat për fshatin Lumadh: trotuar 1000 metra gjatësi, rregullimi i rrrethojës së shkollës e cila ka mbetur në gjysmë, ura në tri përrockat e fshatit, pastrimi i përronjve, kanalizim 1000 metra gjatësi, kycja në sistemin e ujit të pijshëm në lagjen "Hetemi", rrugë për asfaltim 1500 metra gjatësi, një kënd të lodrave tek oborri i shkollës, ura e lumit "Llap", rrugë të rendit të 4-të 1500 metra gjatësi.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30.

Procesmbajtës:

Donjeta Latifi





REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRISË

Lista e pjesëmarrësve

Konsultim publik për Projekt-Buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024 dhe parashikimet për vitet 2025-2026

Vendi: Kuvendi i Komunës

Datë: 11.09.2023

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendi
1	Fatmine Aliu	Fatmine Aliu	Begaj
2	Fikrije Ferizi ^{ATO}	Ferimi	Vushtrri
3	Fatije Gërgaji	F. Gërgaji	Vushtrri
4	SHefkije Muzagi	SH. Muzagi	Begaj
5	Hysni Bektasi	Hysni Bektasi	STANOC I UCL C-MADIT
6	Brahim Mano	B. Mano	Duboci
7	Fehmi Shala	Fehmi Shala	STANOC I SPËRM
8	Melosim Hyseni	Melosim Hyseni	Shf. "Ali Kelmendi" Vushtrri
9	AKB EN Beha	AKB EN Beha	LR. KERCORA VUSHTRRI
10	Xhemajl Bojku	Xhemajl Bojku	F.SH. DRUBR
11	Mohamed Ferati	Mohamed Ferati	F.SH. SFONOGOLI
12	Ilirjan Rizovci	Ilirjan Rizovci	EFS ZHILIVODË
13	Hamzë Makiqi	Hamzë Makiqi	Rezniq
14	Sabile Ejaku	Sabile Ejaku	OSHLAN
15	HABIBE JASHARI	Habibe Jashari	OSHLAN
16	Sadete Januzi	Sadete Januzi	Vushtrri



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRISË

Lista e pjesëmarrësve

Konsultim publik për Projekt-Buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024 dhe parashikimet për vitet 2025-2026

Vendi: Kuvendi i Komunës

Datë: 11.09.2023

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendi
17	Shemsije Maloku		Vushtrri
18	Vilolone Myloku		Vushtrri
19	Romziqe Zeheli		Matlenaj
20	Sevdije Saoliku		Vushtrri
21	MUHAMET RASTAKI		SAMASPEXHE
22	LULZIM SURDULI		SAMADREXHE
23	Artina Llapashtica		Vushtrri
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			